



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-024
Prishtinë, më 17 qershor 2008, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 17 QERSHOR
2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq dhe Xhezair Murati, kurse mungoi (me arsye) Xhavit Haliti;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Ruzhdi Osmani dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Ismet Hajrullahu dhe Eshref Vishi

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Ian Perkins dhe Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

Rend dite

1. Shqyrtimi i kërkesës së kompanisë “ MEGA” – Gjilan lidhur me ndërtimin e Qendrës Protokollare në Gërmi,
2. Miratimi i nismës për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Turqisë,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së për lejimin e udhëtimit zyrtar të anëtarit të këtij komisioni, Shkumbin Demaliaj, në Shën Stefan, Mal të Zi, prej 24 deri më 26 qershor 2008 (Kryesia në mbledhjen e 10 qershorit 2008 ka lejuar udhëtimin e anëtarit të Kryesisë, Ibrahim Gashi, i cili është edhe anëtar i GP të AKR-së, së bashku me shoferin e tij, për të marrë pjesë në takimin e cekur më lart),
4. Shqyrtim i ankesës së kryetares së KETIETT-së, Myzejene Selmani,
5. Shqyrtim i kërkesës së kryetares së KETIETT-së, Myzejene Selmani, për pajisje me kompjuter.

1. Shqyrtimi i kërkesës së kompanisë “ MEGA” – Gjilan lidhur me ndërtimin e Qendrës Protokollare në Gërmi

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë se kompania “MEGA” me seli në Gjilan, i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me një shkresë lidhur me punimet në Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi.

Në debat morën pjesë: Jakup Krasniqi, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, Eqrem Kryeziu, Sabri Hamiti dhe sekretari i Kuvendit.

Kryesia, shqyrtoi kërkesën e kompanisë “MEGA” dhe pas debatit nga anëtarët e Kryesisë, mori këtë

V E N D I M

1. Me qëllim të shqyrtimit të kërkesës së Kompanisë “Mega” nga Gjilani, punëkryes i ndërtimit të objektit Qendra Administrative Protokollare në Gërmi, formohet

Komisioni në përbërje: Jakup Krasniqi, kryetar dhe Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku e Ibrahim Gashi , anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

2. Komisioni, në bashkëveprim me Administratën e Kuvendit do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për shqyrtimin e kërkesës në fjalë, organizimin e takimeve me punëkryerësin “Mega” dhe Kryesisë do t’i paraqesë Rekomandim lidhur me veprimet e mëtejshme që duhet t’i ndërmarrë Kuvendi.

2. Miratimi i nismës për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Turqisë

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë se Komisioni për Punë të Jashtme i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit që ta miratojë nismën për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Turqisë.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet nisma e Komisionit për Punë të Jashtme për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Turqisë.
 2. Grupi i Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës përbëhet nga një përfaqësues i secilit Grup parlamentar dhe nga sekretari i Kuvendit.
 3. Kërkohet nga Grupet Parlamentare që menjëherë të propozojnë nga një anëtarë në këtë Grup të Miqësisë.
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së për lejimin e udhëtimit zyrtar të anëtarit të këtij komisioni, Shkumbin Demaliaj, në Shën Stefan, Mal të Zi, prej 24 deri më 26 qershor 2008 (Kryesia në mbledhjen e 10 qershorit 2008 ka lejuar udhëtimin e anëtarit të Kryesisë, Ibrahim Gashi, i cili është edhe anëtar i GP të AKR-së, së bashku me shoferin e tij, për të marrë pjesë në takimin e cekur më lart)**

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën e deputetit Shkumbin Demaliaj, i propozuar nga Grupi Parlamentar i AKR-së për të marrë pjesë në një seminar të organizuar nga Asambleja Parlamentare e NATO-së, që do të mbahet prej 24-26 qershor 2008, në Shën Stefan, Mal të Zi.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Konfirmohet Vendimi i mëhershëm i Kryesisë nr: V-033, i datës 3 qershor 2008, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ibrahim Gashit, anëtar i Kryesisë për pjesëmarrje në takimin e organizuar në Shën Stefan, Mali i Zi, prej datës 24 deri 26 qershor 2008.

4. Shqyrtim i ankesës së kryetares së KETIETT-së, Myzejene Selmani

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën e kryetares së Komisionit të KETIETT-së, Myzejene Selmani, e cila i ishte drejtuar me shkresë Kryesisë duke shprehur pakënaqësi për moslejimin e kërkesës për transport të anëtarëve të këtij komisioni në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, nxori këtë

P ë r f u n d i m

Deputetët e Kuvendit duhet t'i japin përparësi pjesëmarrjes në seanca plenare, ndërsa puna në teren nga ana e komisioneve mund të bëhet ditëve të tjera.

5. Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së KETIETT-së, Myzejene Selmani, për pajisje me kompjuter.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën e kryetares së Komisionit të KETIETT-së, Myzejene Selmani, e cila ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që t'i sigurohet një kompjuter i ri.

Kryesia pas diskutimeve nxori këtë

Përfundim

Pajisja me kompjuter për kryetar të komisioneve dhe stafin civil është në proces e sipër dhe do të kryhet së shpejti nga Shërbimi përkatës i Kuvendit.

Të ndryshme:

6. Shqyrtimi i kërkesës së Eqrem Kryeziut për pajisje me drita vezulluese të veturave zyrtare të anëtarëve të Kryesisë

Kryesia, pasi u njoftua me kërkesën e anëtarit të Kryesisë, Eqrem Kryeziu, i mbështetur edhe nga anëtarët e tjerë për pajisjen e veturave zyrtare me drita vezulluese, mori këtë

V E N D I M

1. Veturat zyrtare të anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të pajisen me drita vezulluese.
2. Ngarkohet sekretari i Kuvendit që të ndërmarrë veprimet e nevojshme pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme që për mbarëvajtjen normale të punës së anëtarëve të Kryesisë, veturat zyrtare të tyre të pajisen me drita vezulluese.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 11 : 50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale